



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1142

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari I OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Batisha Ibrahim Anetare dhe Vedat Poterqoi Anetar duke vendosur sipas ankesës së OE N.T.SH. “BIZUN”, kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33%” me numër të prokurimit KEK-25-9459-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS” sh.a., më 31/12/2025, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e N.T.SH. “BIZUN” me nr. 2025/1142, e datës 20/11/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33%”, me numër të prokurimit KEK-25-9459-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS” sh.a..

2. **Anulohet** njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33%”, me numër të prokurimit KEK-25-9459-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS” sh.a. AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 16.10.2025, “KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS” sh.a, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33%” me nr.prokurimi: KEK-25-9459-1-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 884,000.00 €.

Me 14.11.2025, OE N.T.SH. “BIZUN” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 18.11.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20.11.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.T.SH. “BIZUN” me nr. 2025/1142 lidhur me aktivitetin “Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33%” me numër të prokurimit: KEK-25-9459-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.SH. “BIZUN” janë parashtruar si në vijim:

Për ta sqaruar kronologjinë e këtij tenderi , në mënyrë që eksperti dhe paneli shqyrtues i OSHP-së ta ketë më të qartë se si ka vepruar KEK me qëllim uljen e konkurrencës, ne do të sqarojmë kriteret që nga inicimi i procedurës e deri më tani: Me datën 17.10.2025 është bërë njoftimi për kontratë dhe kriteret për kualifikim në këtë dosje kanë qenë si më poshtë: Në momentin që kemi shikuar këtë dosje , kemi vërejtur se KEK duke u thirrur në standardin EN 939:2016, tenton ta ulë konkurrencën dhe të na dëmtoj neve si kompani. Ne menjëherë kemi bërë kërkesë për rishqyrtim , ku kemi sqaruar se standardi EN 939:2016 është i dedikuar për të trajtuar kualitetin e acidit klorhidrik i cili përdoret ekskluzivisht për trajtimin e ujërave të pijshëm. Pas kësaj kërkesë për rishqyrtim, KEK na jep të drejtë dhe e heq standardin nga të gjitha pikat ku është kërkuar në DT. Pas përmirësimit të dosjes, dhe zgjatjes së afatit ,ne e vërejmë se parametri i cili buron nga standardi e që është Komponimet organike të halogjenizuara max 17 mg/kg HCl 100% ka mbetur në DT. Ne me datën 28.10.2025 bëjmë kërkesën e dytë për rishqyrtim në këtë lëndë. Në këtë rast, ne kërkuam nga KEK që pasi që është hequr në të gjitha pikat e kërkuara standardi EN 939:2016 dhe duke qenë se KEK u bind se ky standard është diskriminues dhe totalisht irelevant për këtë furnizim, pse ka mbetur parametri i cili buron nga ky standard e që është Komponimet organike të halogjenizuara max 17 mg/kg HCl 100% i cili është totalisht i pa nevojshëm për trajtimin e ujërave në KEK. Përgjigja nga KEK ka qenë shumë jo profesionale, në të shifet tendenca se përfundimisht tentojnë ta ulin konkurrencën në mos me standardin si titull atëherë me ndonjë nga parametrat të cilët burojnë nga

ky standard e që më poshtë ne do të sqarojmë për OSHP-në në detaje se pse ky standard dhe parametri Komponimet organike te halogjenizuara është i panevojshëm dhe se e ulë konkurrencën. Përgjigja e tyre ishte se ne kemi vendosur mos ta largojmë këtë parametër që buron nga standardi, për shkak se janë modernizuar sistemet në elektrane dhe se acidi klorhidrik i cili përdoret për trajtimin e ujërave të pijshëm do të ndikoj për ta mbrojtur procesin teknologjik, pajisjet dhe rrëshirat. Ne u sqarojmë se KEK-u që nga themelimi , historikisht përdorë acid klorhidrik i cili është i destinuar për trajtimin e ujërave të cilët nuk kanë destinim konsumin njerëzor. Asnjëherë në histori të zhvillimit të tenderëve për furnizim me acid klorhidrik, përveç disa tendencave, nuk ka qenë kriter standardi EN 939 dhe parametri i specifikimit teknik Komponimet organike te halogjenizuara . Me qenëse jemi në tregun e kimikaleve prej 16 viteve, ne kemi jemi njëri ndër furnitorët që në vazhdimësi kemi furnizuar KEK-un me një apo disa kimikate. Kjo është arsyeja se ne e njohim edhe sistemin e punës me kimikate në KEK. Që nga ndertimi i TCA dhe TCB nuk është ndryshuar asgjë në materialin e kolonave, te kazanit dhe te turbines, pjesë te cilat lidhen me kualitetin e ujit dhe avullit. Kete sqarim po e bëjmë për OSHP-në në mënyrë që të dihet se që nga ndërtimi i elektranave dhe aktualisht përdoret acidi klorhidrik i cili nuk ka si parametër Komponimet organike te halogjenizuara. Ky acid nuk ka shkaktuar demë as probleme në sistemet e cekura me lartë, te cilat mund të modernizohen/ rivitalizohen, mirepo në thelb mbete i njejti material . Cka don të thotë që edhe specifikat e ujit/avullit duhet me qene te njejta , si rrjedhojë acidi i perdorur historikisht në KEK mund dhe duhet te përdoret në vazhdimësi. Në si kompani , në disa periudha si dhe aktualisht jemi duke furnizuar KEK-un me acid klorhidrik i cili NUK është i destinuar për trajtimin e ujërave të pijshëm, por që vlenë të theksohet se prodhohet në Hungari nga prodhuesi Borsodchem , që është prodhuesi më i madh në Evropë dhe se produktet e këtij prodhuesi shiten në të gjitha elektranat dhe kompanitë e ndryshme që trajtojnë ujëra jo të pijshëm. Në kurrë asnjë ankesë më të vogël nuk e kemi pas në kualitetin e produktit të furnizuar, që do të thotë se ky produkt as nuk ka shkaktuar as nuk është duke shkaktuar as më të voglin problem në sistemet ku qarkullon uji në elektrane. Aktualisht sot, KEK është duke përdorur acidin klorhidrik të prodhuesit Borsodchem i cili nuk përmbanë parametrin Komponimet organike te halogjenizuara . Me këtë DT, KEK tenton ta largoj nga tregu prodhuesi Borsodchem e me crast edhe ne si kompani. Vlenë të theksohet se prodhuesi të acidit klorhidrik në rajon dhe pjesën lindore të Evropës ka vetëm dy prodhues ata janë Borsodchem nga Hungaria dhe Chimcomplex nga Rumania. Me kërkesat e këtij standardi KEK i le hapësirë konkurimit vetëm prodhuesit Chimcomplex. Në e themi këtë për shkak se ky produkt pothuajse aq sa e ka koston e prodhimit, e ka koston e transportit ku për pasojë të gjitha kompanitë e kanë të pamundur të dalin me cmime të tregut sepse sa më larg që është prodhuesi do ta rrisë koston e transportit . Ky produkt është produkt i rrezikshëm, i cili kërkon leje të kalimit nga shteti në shtet e që në sa më shumë shtete të kalojë ky produkt, do të rritet kostoja e pageses së lejeve tranzit, do të ndikoj në afatet e liferimit për shkak të periudhës së nevojës për marrjen e lejeve dhe të gjithë dokumenteve administrative që kërkohen. Këtë sqarim e bëjmë për ta pasparasysht paneli shqyrtues se me vendosjen e këtyre kriterëve nga KEK mundësia për konkurim në këtë tender do të mbetet vetëm tek një prodhues i cili ka vetëm një diller në Kosovë e me crast do të ketë mundësi të rritjes anormale të cmimit dhe përfitimit të individëve , por asesi të KEK-ut si institucion dhe shtetit të Kosovës. Andaj parametri Komponimet organike te halogjenizuara shkel nenin 1 të LPP-se, që është qëllimi i shpenzimit sa më efikas i parasë publike si dhe ulë konkurrencën pa asnjë nevojë. Gjithë këtë që e tham më lartë, se ky standard është i dedikuar për vendosjen e parametrave , mënyrës së prodhimit, të acidit klorhidrik i cili përdoret për trajtimin e ujërave për konsum njerëzor, ne do të bashkëngjesisht kësaj ankese pjesë të standardit ku sqarohet që nga emërtimi e deri te kriteret e tjera në brendi se ky standard është i dedikuar për acidin klorhidrik për trajtimin e ujërave të pijshëm. Pjesët e këtij standardi që do të bashkëngjiten ankesës, janë të ndaluara të shpërndahen , riprodhohen nga Agjencia Kosovare e Standardizimit.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër N.T.SH. "BIZUN" konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim Neni 1 Qëllim Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi Neni 28 Specifikimet teknike pika.2. Në kushtet OSHP-ne që bazuar në faktet e lartëcekura ta ndalojë tendencën e KEK-ut që duke ulur konkurrencën me crast do të rritet çmimi ta shkelë LPP-në e duke shkelur LPP-në të na dëmtoj në si kompani dhe prodhuesin evropian Borsodchem.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim: Sqarimi Lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33%" kërkesës të AK-së ka shqyrtuar kërkesën Prishtinë dhe refuzon me arsyen se: Pretendimet e paraqitura janë të pabazi EN 939 është hequr nga DT-ja, Autoriteti parametra minimale teknike, të domosdo mbrojtjen e rrëshirave gjatë rigjenerimit Parametri "komponimet organike të halc prodhues. Ai është parametër i njohur në vendoset për të mbrojtur procesin tekno Përcaktimi i parametrave teknike nuk bë nevojave të procesit teknologjik dhe funksion për sa kohë i plotëson kërkesat minimale

Prandaj, nuk ka bazë që ky parametër të izim me Acid Klorhidrik 31-33% " KEKO-25-280-111 inicuesit e për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues OE BIZUN NTSH- ara, si teknikisht ashtu edhe procedurialisht. Edhe pse standardi Kontraktues ka të drejtë ligjore dhe profesionale të përcaktojë Dshëm për përdorimin e HCl-së në proceset e PKU-së dhe për gjenizuar" nuk është diskriminues, as specifik për ndonjë ërkombëtarisht për kontrollin e pastërtisë së acidit dhe ogjik, pajisjet dhe rrëshirat, jo për të kufizuar konkurrencën.

Dhe në bazë të katalogëve të prodhuesve, por në bazë të oionimit të sigurt. Produkti i çdo prodhuesi është i pranueshëm të DT-së. Prandaj nuk ka bazë që ky parameter të paraqitet nga Dosja e Tenderit.

REKOMANDIMI I INICUESITË KËRKESËS

Komisioni i vlerësimit të AK në bazë të sqarimit të lartëcekur për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik : BIZUN NTSH- Prishtinë "Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33%" ,me nr. prokurimit: KEKO-25-280-111 të refuzohet rekomandon Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit që kërkesë të për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33%" si e pa bazuar.

KONKLUZIONI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në kërkesën për rishqyr është i pakënaqur me vendimin e autoritetit kontraktues si d të vlerësimit të AK për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim te OE BIZUN NTSH - prishtinë te Operatorit Ekonomik: BIZUN NTSH- Prishtinë i cili dhe analizën, sqarimet dhe rekomandimin e komisionit Acid Klorhidrik 31-33% " KEKO-25-280-111 e refuzon si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim te OE BIZUN NTSH – Prishtinë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, OSHP me datë 24.11.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1142/2025, ndërsa me datë 03.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/1142 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale, AK nuk pajtohet ndërsa OE nuk ka dhen përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.T.SH. “BIZUN” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1142 ka vlerësuar si në vijim:

KONSTATIMET LIDHUR ME PRETENDIMET E OE-NTSH-BIZUNI për Aktivitetin i prokurimit :
Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33% me nr. të prokurimit KEK-25-9459-1-1-1 të inicuar nga Autoriteti Kontraktues KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a

Konstatimi 1 Qendron pretendimi i OE NTSH-Bizuni se është shkelur nuk është respektuar Neni 7 i LPP-së Barazia në trajtim /Jo-Diskriminimi, sepse me vet faktin vendosjes se Standardit EN 939: 2016, KEK sh.a ka vendosur kriter diskriminues.

Konstatimi 2, Qëndron dhe është i bazuar pretendimin ankimor se AK-KEK sh.a ka kërkuar specifikime te detyrueshme Neni 28 pika 2, për HCl sikurse qe kërkohen për trajtimin e ujërave te pijshëm, çka nuk është njëjt sikurse te kërkohet klor për trajtimin e ujit te pijshëm, sikur te kerkohet HCl për trajtimin ujërave industriale.

Konstatimi 3-Qëndron dhe është i bazuar pretendimi ankimor i OE-NTSH-Bizuni, sepse KEK sh.a ka vendosur kriter diskriminues Standardin EN 939: 2016,i cili standard kërkohet për furnizim me klor (Cl) për trajtimin e ujërave të pijshëm, dhe nuk duhet të kërkohet për trajtimin e ujërave industrial.

Konstatimi 4-Qendron dhe është i bazuar pretendimi i OE ankues-NTSH-Bizuni se komponenta përbërëse organike e halogjenizuar janë burim i parametrave te standardit EN 939:2016, sepse është ne standardin EN 939:2016, vërehet se komponenta përbërëse organike e halogjenizuar është e vendosur dhe kërkohet HCl(acidin klorhidrik) vetëm për ujërat e pijshëm

Specifikimi teknik, Parametrat kimik, komponimet organike te halogjenizuara max 17 mg/kg HCl 100%

Rekomandim-Pas shqyrtimit dhe analizimit te ankesës se OE Ankues-NTSH-Bizuni, propozoj këtë Rekomandim : Se duhet te largohet nga FDT-Dosja e Tenderti kriteri dhe nënkriteri diskriminues qe minimizon konkurrencen me rastin e kërkesës se panevojshme ta Standardit EN 939:2016, vërehet se komponenta përbërëse organike e halogjenizuar është e vendosur dhe kërkohet HCl(acidin klorhidrik) vetëm për ujërat e pijshëm

Qe ky aktiviteti i prokurimit Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33% me nr. të prokurimit KEK-25-9459-1-1-1 të inicuar nga Autoriteti Kontraktues KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a, duke marrur dhe duke pasur parasysh , sepse pothuajse të gjitha pretendimet ankimore te OE Ankues lidhur me

specifikacionet teknike te detyrueshme qëndrojnë dhe janë te bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33%” me nr. të prokurimit: KEK-25-9459-1-1-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Acid Klorhidrik 31-33%” me nr. të prokurimit: KEK-25-9459-1-1-1, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rrjedhimisht paneli shqyrtues konstaton qe ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- **OE - N.T.SH." BIZUN "**
- Arkivës së OSHP-së: